



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:058086

Datë: 10.10.2023

Numri i dokumentit: 04773231

C.nr.2545/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z. M. nga fshati Bellopojë, Komuna e Podujevës, cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokatura sh.p.k.” M...””, me avokatët M. S., B. S. dhe N. S. nga Prishtina, ndaj të paditurës Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” Sh.A., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Flora Çekaj Llapashtica, zyrtare ligjore tek e paditura, për kompensimin e shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së seancës së datës 26.09.2023, me datë 10.10.2023 mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z. M. , Komuna e Podujevës dhe DETYROHET e paditura Ndërmarrja Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” Sh.A., që paditësit në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 40 vite përvojë pune t’ia paguajë shumën prej 1,436.22 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 28.05.2020 kur është parashtruar padia, e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 269.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarve të tij, me datë 28.05.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës, duke kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurën që në emër të kompensimit për shpërblim jubilar t’i paguajë paditësit shumën prej 1,463.22 euro.

Në padi ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri me datë 30.12.2019 kur i ka plotësuar kushtet për pension të pleqërisë, ku ka punuar pa ndërprerje për 43 vite, ndërsa tri pagat e fundit të tij kanë qenë në vlerë prej 477.65, 487.74 dhe 487.89.

Ndërsa, në seancën e datës 26.09.2023 përfaqësuesi i paditësit ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ku ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditësit t’ia paguajë shpërblimin jubilar për tri paga mujore në vlerë prej 1,436.22 euro. Ka shtuar se paditësi i ka 43 vite përvojë pune, ndërsa vitin jubilar e ka arritur në vitin 2016, e që paditësi ka tentuar që të arrijë

marrëveshje me të paditurën dhe të njëjti i është premtuar se në rastin e daljes në pension përveç pagave përcjellëse të cilat ia ka paguar, do t'i paguhet edhe kompensimi për shpërblim jubilar, mirëpo të njëjtit me vendimin 869 të dt.06.12.2019 nuk i është përmbushur ky detyrim, por vetëm pagat përcjellëse.

Shpenzimet i ka kërkuar, dhe atë 104 euro për përpilimin e padisë, 30 për taksë gjyqësore si dhe 135 euro për përfaqësim në një seancë.

E paditura në përgjigje në padi dhe në seancën e datës 26.09.2023 e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit për shkak se e njëjta nuk ka bazë ligjore në ligjin e punës, e sa i përket Kontratës së Përgjithshme Kolektive, e njëjta ka pasur vlefshmëri nga data 01.01.2015 deri më 31.12.2017, dhe i njëjti ka mundur që gjatë asaj periudhe ta shfrytëzojë këtë të drejtë. Ka shtuar se e paditura nuk ka pasur kontratë as nuk ka kontratë kolektive që e rregullon këtë çështje e as nuk parashihet në rregulloren e punës apo ndonjë akt të brendshëm.

Gjykata konstaton se gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që në seancën e datës 26.09.2023 palët ndërgjyqëse njëzëri kanë deklaruar se nuk është kontestuese përvoja e punës e paditësit prej 43 vitesh dhe se arritja e 40 viteve jubilarë është bërë në vitin 2016. Për palët nuk ishte kontestuese as lartësia e tri pagave të fundit të paditësit të cekura si në padi. Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte vetëm baza ligjore e kërkesës së paditësit, pasi që sipas të paditurës kjo kërkesë e tij nuk parashihet me asnjë akt ligjor.

Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që e aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në rastin konkret lidhur me bazën e kërkesëpadiës duhet të zbatohet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK), e miratuar dhe e nënshkruar nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) me datën 18.03.2014, e cila ka qenë e zbatueshme prej datës 01.01.2015, e deri me datë 31.12.2017.

Neni 52 i MPKK-së ka paraparë që *“1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.”*

Ndërsa, neni 2, parag. 1 i MPKK-së ka paraparë që *“Dispozitat e MPKK, obligojnë palët në Marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje)”*.

Në rastin në fjalë gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim t'ia paguajë paditësit kompensimin për shpërblimin jubilar. Kjo për faktin se ky detyrim është paraparë me nenin 52, paragrafi 1.3 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të vitit 2015, i cili akt nënligjor ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi ka arritur vitin jubilar, pra në vitin 2016.

Lidhur me lartësinë e shpërblimit jubilar gjykata u bazua në deklaratimet e palëve sipas të cilëve nuk ishte kontestuese se vlera e tri pagave të fundit të paditësit ka qenë 477.65, 487.74 dhe 487.89, e që në total bëjnë 1,453.28, por që gjykata vendosi që ta aprovojë shumën prej 1,436.22, pasi që aq ka qenë kërkesa e paditësit në seancën e datës 26.09.2023.

Kështu, gjykata nga të gjeturat e cekura më lart e ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit për tri paga mujore për shpërblimin jubilar t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1,436.22 euro.

Sa i përket kundërshtimit të të paditurës se kërkesëpadia e paditësit nuk ka bazë ligjore, gjykata këtë kundërshtimi nuk e mori për bazë për të vendosur ndryshe, kjo për faktin se nga baza ligjore e shtjelluar më lart nga gjykata, u pa qartë se kërkesëpadia e paditësit është plotësisht e bazuar, dhe atë në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Lartësia e kamatës prej 8%, është përcaktuar në bazë të nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe e njëjta do të llogaritet në shumën e aprovuar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumën prej 269.00 €, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104 euro, 30 euro në emër të taksës gjyqësore dhe 135.00 € për një seancë gjyqësore, e duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga se u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.2545/20, datë 10.10.2023

Gjyqtari  
Freskim Musliu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.